



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2023:209481

Datë: 30.01.2025

Numri i dokumentit: 06782694

C.nr.675/23

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTINE DEGA NE LIPJAN-Departamenti i përgjithshëm, në përbërje prej gjyqtarit Avdirrahman Gashi, gjyqtar individual, me pjesëmarrjen e praktikantes Gresa Bajrami , në çështjen kontestimore të paditësit Kompania e Sigurimeve KS “S.” me seli në P. ndaj të paditurit J.M. me vendbanim në fsh.Sh., K.L., për shkak të rimbursimit borxhi në seancën gjyqësore të mbajtur me dt.30.01.2025, në mungesë të palës paditëse merr këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET e tërhequr padia e paditësit Kompania e Sigurimeve KS “S.” me seli në P., ndaj të paditurit J. M. me vendbanim në fsh.Sh., K.L. në këtë çështje kontestimore. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi Kompania e Sigurimeve KS “S.”me seli në P. ndaj të paditurit J. M. me vendbanim në fsh.Sh., K.L. në këtë gjykatë ka paraqitur padi për rimbursimit borxhi.

Gjykata ka caktuar seancën përgaditore për datën 30.01.2025, dhe nga pala paditëse nuk ka prezantuar askush edhe pse ka qenë e ftuar në mënyrë të rregullt, mungesën nuk e ka arsyetuar dhe shtyerjen nuk e ka kërkuar.

Meqenëse pala paditëse ka qenë e ftuar në mënyrë të rregullt për seancën e datës së lartëcekur dhe mungesën nuk e ka arsyetuar, për këtë gjykata konform nenit 409.1 të LPK-së, e konsideroi padinë e paditësit të tërhequr.

Vendimi për shpenzimet e procedurës u bazua në nenin 450 të LPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN

C.nr.675/23 të dt. 30.01.2025

GJYQTARI

Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve nga dita e dorëzimit të këtij aktvendimi. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit, përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2023:209481
Datë: 30.01.2025
Numri i dokumentit: 06782694